



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 84
Prishtinë, më 5.7.2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Albena Reshitaj, Enis Kervan, Adriana Matoshi, Arjeta Fejza, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj dhe Eliza Hoxha.

Munguan: Ardian Kastrati dhe Vlora Durmoshi.

Në mbledhje mori pjesë: Hasnije Ilazi, Maja Martinoviç, Avni Berisha, Gëzim Tosuni, Mirlinda Batalli dhe Jetmir Haxhibeqiri nga KSHC i AKA; Naim Gashi nga AKA, si dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.6.2024;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2023;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.6.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25.6.2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2023

Ardian Gola, kërkoi nga kryetarja e KSHC-së, që ta prezantojë raportin vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2023.

Hasnije Ilazi, tha se dje kanë përfunduar vizitën treditore anëtarët e ENQA-s, në Kosovë, të cilët kanë bërë vlerësimin e punës të Agjencisë për kthimin e tij me drejta të plota në ENQA dhe EQAR. Janë takuar edhe me aktorë tjerë institucionalë, studentë e donatorë në Kosovë, për të përfituar një përshtypje dhe në fund kanë pasur një takim përmbyllës para se të japin rekomandimet e tyre. Ata kanë potencuar se ka pasur një progres jashtëzakonisht të madh prej kohës kur Agjencia ka qenë e përjashtuar nga ENQA. E falënderoj Komisionin dhe Kuvendin për miratimin e Ligjit për Agjencinë. Tha se KSHC ka mbajtur njëmbëdhjetë takime të rregullta, dy votime online, kanë përcjellë kërkesat/ankesat në Komisionin e Ankesave dhe janë marrë vendime në lidhje me këtë. Në vijim, tha se prioritet i tyre për 2023 ka qenë: krijimi i dokumentacionit që derivon nga ligji, që janë bërë disa arritje, pra ato që kanë qenë në përgjegjësi të Agjencisë. Tha se përfaqësues të Agjencisë janë anëtarë të grupit punues për nxjerrjen e udhëzimeve administrative, që janë përgjegjësi e Ministrisë. Një e arritur kryesore që përmendi ishte organizimi i konferencës së parë ndërkombëtare për cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë dhe rajon, me përfaqësim të institucioneve më të larta në Evropë dhe rajon. Një e tillë, tha se do të mbahet dhe komisioni do të njoftohet lidhur me këtë. Kanë vazhduar takimet e rregullta me institucionet e arsimit të lartë, kanë pasur vizita jashtë vendit, takime me përfaqësues të ENQA-s, në samite të tyre, konferenca, me agjenci individuale (ceki atë në Sllovaki, që ka fituar anëtarësimin në ENQA këtë vit dhe kanë marrë përvoja që ju kanë ndihmuar për vizitën e ENQA-s).

Arijeta Rexhepi, përgëzoi për punën dhe theksoi se pjesa më e rëndësishme dhe e mirë, që ju ka pëlqyer të gjithëve, beson se ishte konferenca ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë për arsimin e lartë, që ka pasur një pjesëmarrje shumë të mirë, me diskutimet që janë mbajtur dhe përkrahja nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare për një cilësi sa më të mirë në arsimin e lartë. Po ashtu, theksoi se hyrja në fuqi e Ligjit për Agjencinë për Akreditim, ku sipas raportit, Kosova ishte e para në rajon që ka vënë një ligj të tillë, për të cilin mburremi së bashku. Gjithashtu, kanë bërë përgatitjet e duhura për vitin 2024 dhe kanë qenë të kujdesshëm edhe në aspektin e kërkimit të deklaratimit të pasurisë së profesorëve. Deputetja parashtrroi disa pyetje në lidhje me raportin: njohja e diplomave (nostrifikimi) sipas legjislacionit në fuqi nuk është në harmoni me mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Si rrjedhojë, përveç asaj formale dhe anës procedurale, në këtë aspekt, sa e kanë parë si sfidë këtë çështje që e kemi mundësinë për ta rregulluar nga përvoja e tyre? Në këtë rast, a kanë një bashkëpunimin të mirëfilltë me NARIKU-n, që të kemi diploma që ndikojnë në cilësi, që mos të na ndodhë e kundërta? Pika tjetër ishte te mungesa e kompetencës

formale për orientimin e programit të studimit. Pyeti: sa është e interesuar MASHTI në këtë aspekt? A ka kërkuar nga Agjencia të ketë një raport, se cila nga programet, ku këtu KSHC në raport kanë përmendur se nuk kanë mekanizëm ligjor për orientimin e programeve studimore drejt profileve që janë në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe tregut, sa është bashkëpunimi me MASHTI-në, për të mos ardhur në situata të tilla? Ndërsa për validimin e akreditimit të marrë jashtë, ku KSHC është në hartim e sipër të rregullores për validim, që do të elimojnë dallimet esenciale në procedurat e akreditimit në mes të programeve të akredituara në Kosovë dhe ato ndërkombëtare. Shtroi pyetjen: nga cili ligj aktual do të buronte një rregullore e tillë, pra a është aspekti ligjor i gatshëm, ku ata mund të fillojnë punën në këtë aspekt? Më tutje, shtroi pyetjen: a është e mjaftueshme që të kryhen vlerësimet online, a duhet të jenë gjithsesi takime fizike, pra cila është më e përshtatshme? Në vijim, shtoj se në 2023 janë paraqitur dymbëdhjetë institucione për akreditim institucional, dhjetë i janë nënshtruar vlerësimit, ndërsa dy nuk i janë nënshtruar, pasi që nuk kanë pasur të aprovuar programet e studimit. Pyeti: a duhet të ketë një aprovim tek institucionet e pastaj të programit të studimit? pyetja ishte se përse ka ndodhur ky rotacion? Pika e fundit e deputetes ishte për draftin e dokumentit “Kosovo Subject Area Code”, për t’iu mundësuar institucioneve të arsimit të lartë, që të identifikojnë dhe përshtatin stafin akademik me programin e studimit që ata do jenë bartës. Lidhur me këtë, pyeti: në cilën fazë është dokumenti?

Hasnije Ilazi, tha se sa i përket çështjes së nostrifikimit, sfida kryesore që e kanë konstatuar, ka qenë me vendimmarrjen e tyre me fushat e programeve, respektivisht adaptimin e bartësit të programeve që duhet të dëshmojnë që i përkasin një fushe të caktuar, për arsye se nostrifikimet për stafin që ka përfunduar studimet jashtë Kosovës, vërtetimi që lëshohet nuk tregon shumë rreth asaj, nuk shkruan nga cila fushë ose departament vjen, pra nuk ka shumë informata dhe kjo është sfiduese për të detektuar se cilës fushë i përket bartësi potencial të programeve. Kanë diskutuar me përfaqësues të NARIC-ut rreth kësaj çështjeje, por duhet të rregullohet nga MASHTI ose Qeveria, që të përcaktohet saktësisht procedura e nostrifikimit. Më herët kanë qenë komisione profesionale, ku për shembull, kur është nostrifikuar një dokument i një profesori ose asistenti, ka qenë një komision që ka ardhur nga profesionistët e asaj fushe, që kanë bërë krahasime të programit që ka studiuar personi me programin që e ka përfunduar jashtë. Më pas, kanë konkluduar nëse programi në fjalë mund të konsiderohet adekuat. Por, kjo formë nuk është më ekzistuese ndër vite. Tani është vetëm një përgjigje formale, ku NARIC-u kërkon përgjigje nga institucioni jashtë, ku ka studiuar personeli, konfirmohet që i ka përfunduar studimet dhe ka diplomë. Pra, nuk ka detaje tjera. Ndërsa, sa i përket programit që duhet të reflektojnë nevojat e shoqërisë dhe tregut, nuk është në mundësitë e tyre të ndërhyjnë në lirinë akademike të institucioneve të arsimit të lartë. Moshartimi i dokumenteve strategjike që japin një orientim se çka është prioriteti i shtetit, dhe natyrisht institucionet e arsimit të lartë do të duhej të orientohen sipas atyre dokumenteve, por kjo nuk ndodh gjithmonë. Agjencia mund të bëjë në këtë drejtim analiza tematike, me temën më të rëndësishme në moment, hulumtim rreth sa përshtaten, ku kjo është bërë edhe më herët. Por, nga zhvillimet e mëdha, një analizë e para një ose dy viteve, nuk është më aktuale. Ata mundën me hulumtime të bëjnë një pasqyrë që prezantohet para institucioneve, dhe para komisionit, por mbetet që institucionet janë të lira të vendosin për programet që ata mendojnë që mund të zhvillohen në mënyrë cilësore në institucionet e tyre. Sa i përket çështjes së validimit, tha se e kanë përgatitur draftin e parë të rregullores, ku janë angazhuar ekspertë të jashtëm dhe vendorë, për të përfshirë edhe përvojat e vendeve tjera, dhe në muajt në vijim, e njëjta do të miratohet.

Sa i përket vlerësimeve online, tha se si institucion, parimisht e favorizojnë vlerësimin me pjesëmarrje fizike. Vlerësimi online është përdoruar gjatë pandemisë dhe janë në përgatitje të Rregullores për Akreditim online.

Naim Gashi, tha se aplikimi për akreditim institucional dhe të programeve, me rregullativën e kaluar, kanë qenë në një periudhë të njëjtë kohore nga 1 deri më 30 tetor. Pra, aplikojnë edhe për akreditim institucional dhe të programeve. Shpjegoj se dy rastet e vetme, ku është paraqitur diskrepanca mes rotacionit të aplikimit për akreditim institucional dhe të programeve, ishte kur kanë bërë verifikimin e stafit. Shembull, ata që kanë aplikuar në dy programe, ku të dy programet janë refuzuar, si rrjedhojë institucioni tërhiqet, pasi që nuk i nevojitet akreditim institucional kur nuk e ka atë të programeve. Këto janë dy rastet e vetme, që janë shpjeguar edhe në raport. Me ligjin e ri, aplikimi bëhet me 1-31 korrik, nëse programet aprovohen nga KSHC, i nënshtrohen aplikimet institucional, dhe pasi të marrin përgjigje për vlerësim institucional, vazhdon me vlerësimin e programeve.

Gëzim Tosuni, lidhur me procesin e njohjes së diplomave, tha se është kompetencë e NARIC-ut. Ndërsa, rreth baraspeshimit të diplomave është si proces më i komplikuar, ku duhet të ketë komisione të veçanta, që të trajtohet secila lëndë.

Hasnije Ilazi, sa i përket çështjes së ngritur lidhur me “Kosovo Area Code”, ende nuk është përfunduar, duke pasur parasysh agjendën e ngarkuar të Agjencisë me vizita dhe me procesin e aplikimit në ENQA. E kanë përcaktuar brenda manualit të ri dhe ka disa opsione që konsiderohen, që japin një orientim të ri, diploma e doktoratës, punimet, dhe për herë të parë, sipas ligjit, e kanë marrë parasysh edhe përvojën e profesorëve si ligjërues.

Eliza Hoxha, në diskutimin e saj ngriti dy çështje. Fillimisht, tha se ka pasur shumë shpesh ankesa për zbatimin e Udhëzimit Administrativ 15/2018, specifikisht për akreditimin e programeve për Bachelor profesionale, ku potencoj se është mirë të diskutohet për nenin 26, pika 5.3.7, që i përjashton kriteret që janë të parashtruara më herët në raport me programet Bachelor profesionale, në raport me PhD ose kërkesa tjera të caktuara, prandaj kërkoi sqarim se pse qëndron kjo. Te pjesa e njohjes së diplomave, tha se ky është një problem ndër vite. Po ashtu, tha se njerëzit që t'i adaptohen tregut, bëjnë disa masterë të ndryshëm, PhD të dyfishta, për t'iu përshtatur tregut dhe për të krijuar mundësi të reja për veten.

Hasnije Ilazi, sa i përket çështjes së parë, problemi ka qenë te programet shkencore, që njëkohësisht janë specifike që a të kenë PhD apo jo. Në këtë rast, problemi kryesor ka qenë me fakultet të arteve. Pasi që kur ka përfunduar Udhëzimi Administrativ paraprak, tani janë në një vakum ligjor, ku UA tjetër, që mund ta rregullojë këtë çështje, ende nuk është në fuqi, e tani ligji i obligon për të kërkuar PhD për çdo program shkencor. Përfaqësues të Agjencisë janë pjesë e grupit punues me MASHTI-në, ku janë takuar dje për UA, që do të rregullojë këtë çështje të programeve që kanë specifikat e veta si, p.sh. të arte. Programet që janë pezull për shkak të kësaj çështjeje, do të trajtohen menjëherë, si të hyjë në fuqi UA. Një prej propozimeve ka qenë nëse konsiderohen dhe është mundësia sipas Ligjit për Agjencinë, dhe janë të parapara si prioritetet nacionale. Agjencia mund ta shtyjë për një vit akreditimin. UA do të rregullojë edhe çështjen e programeve për komunitetet.

Eliza Hoxha, tha se programet Bachelor të gërshetuara profesionale edhe shkencore, te Fakulteti i Arteve e Arkitekturës kërkon PhD në lëndë që nuk janë teorike, por praktike e kreative, më shumë. Më pas, ka profesorë që kanë PhD, por nuk kanë njohuri profesionale, teknike dhe kreative të duhura dhe rezultate në lëndën që ligjërojnë, që është shqetësuese. Për arkitekturë është reduktuar në vetëm 5 punime, për t'u bërë profesor, e ndryshe kërkohet në terren. Si i trajtojmë ne programet e gërshetuara dhe si vijnë tek Agjencia për Akreditim?

Hasnije Ilazi, tha se kur institucioni aplikon për akreditim, në aplikacion deklarojnë se a po aplikojnë për profesional apo shkencor, vetë e vendosin atë kodin dhe nivelin që po aplikojnë. Këto specifika nuk janë zgjidhur, ka qenë në Udhëzim Administrativ, përkohësisht. Ata janë të alarmuar që duhet të bëhet një zgjidhje afatgjatë, ku të kenë mundësinë të jenë më fleksibilë. Ata e dinë se jo krejt stafi mund të jenë bartës. Së paku, ata që mund të konsiderohen si bartës, duhet të kenë disa rregulla, të tjerët jo. Te Fakulteti i Arkitekturës dhe Arteve, ka me doktoratë që nuk përdoren si bartës të programeve dhe kjo është si punë e brendshme e institucioneve. Me këtë udhëzim dhe riformulim të ligjit, mund të rregullohet më mirë kjo çështje. Ata janë për pranimin e specifikave e jo për dënimin e tyre. Brenda manualit kanë që edhe masterët duhet të merren parasysh për bartës, nëse ka pasur ndryshim të interesave mes master dhe PhD, edhe ato pranohen. Gjithashtu, praktikat që po marrin parasysh janë programet me diplomë të dyfishtë, por kjo pjesë nuk është shumë e rregulluar.

Eliza Hoxha, tha se në sferën e energjisë dhe qëndrueshmërisë, rishtazi kurrikulat janë ndërruar komplet në fakultet tek ata dhe nuk ka PhD profesor, megjithatë ka pasur një master shkencor me ndërkombëtarë dhe lokalë që është bërë. Aq shpejt po ndërrojnë kërkesat e tregut, aq shpesh po duhet ndërruar kurrikulën, sa që nuk mund të mbërrish për ta përfunduar PhD, tërë kohën, pa u ndalur.

Enis Kervan, kërkoi sqarim për Fakultetin e Edukimit, ku nuk janë riakredituar programet parashkollor dhe fillor në Prizren. A është çështja që nuk janë plotësuar kushtet dhe kriteret, pasi që ka informata që në Pejë dhe në Prishtinë, dy programe nuk janë riakredituar, por një është riakredituar, ndoshta është gabim, por pse nuk ka ndodhur në Prizren, në përgjithësi, kështu? Përndryshe institucionalisht kanë pasur bashkëpunimin shumë të mirë me ta për programet e gjuhëve të komuniteteve turke, boshnjake dhe e falënderon për bashkëpunimin, edhe pse ligji dhe Kushtetuta garanton arsimin, por pa pasur bashkëpunimin dhe përkrahjen nga ana tyre, nuk mund të arrihet deri sot. Sipas nenit 28, pika 10 e ligjit, i obligon të kenë Udhëzime Administrative nga ministria përkatëse dhe i vjen mirë që edhe ata janë pjesë e këtij ekipit. Uron që udhëzimi të bëhet mirë, pasi që komunitet jo-shumicë, kur ka kuadro, kanë nevojë për programe të reja. Kanë pasur raste edhe për gjuhën turke dhe boshnjake në Prizren, kanë aplikuar, por ata ia gjuajnë topin njëritjetrit. Rektori thotë se jo unë nuk mundem, ngjashëm veprojnë edhe Këshilli dhe Senati. Në udhëzim duhet të caktohet një adresë, ku duhet aplikuar kërkesa, ku duhet të drejtohet dhe kush merr vendim. Duhet të kryhet kjo punë, për shkak se nuk është që nuk ka vullnet, por secili nuk dëshiron të marrë përgjegjësi. Ai mendon që bordet e universiteteve për atë ekzistojnë, ku marrin çdo kërkesë për programet e reja, adresohen në bord dhe merren vendimet. Pyetja që parashtrroi deputeti ishte se a është më mirë Udhëzimi Administrativ, sipas nenit 28, të jetë veç për komunitete, apo bën për t'i përfshirë 2-3 çështje, sepse neni 28 është i qartë dhe thotë se vetëm për komunitetet flet dhe Ministria thotë duhet nxjerrë udhëzim, por më pas mos del ndonjë problem ligjor. Për të çka është e rëndësishme është që a do reflektohet te grupi që është themeluar për

miratimin e rregulloreve, të reflektohet edhe te rregulloret e tyre, pra mos të mbetet vetëm në UA, pra më mirë të jetë edhe tek ata, si institucion.

Hasnije Ilazi, mendon që udhëzimi që e kanë hartuar është i tillë që i mbulon dy çështjet e ngritura. Fillimisht, garanton programet në gjuhën e komuniteteve, pa asnjë dallim dhe njëkohësisht e ruan cilësinë dhe zhvillon programet. Përpara ka qenë UA që thotë se kjo është për 5 vite, e ndërkohë duhet të zhvillohen, e tash ka hapa konkretë, që nënkuptojnë si një diskriminim pozitiv, por njëkohësisht kanë për të zhvilluar institucionin. Kjo formulë, në pajtim edhe me prorektoren e Prizrenit, janë të kënaqur me plotësimin e dy kriterëve. Për sa i përket për programet e edukimit, nuk janë të njëjta rastet kur bëhen krahasimet mes programeve për bartësit e programeve. Secili institucion i ka specifikat e veta dhe nuk i kanë kandidatët e njëjtë ose fushën e njëjtë. Programet, për shembull, që kanë pasur tre bartës, njëri diskutabil rreth fushës, është marrë nga programi tjetër dhe ka qenë po i kësaj fushe dhe ka pasur mundësi të kalojë si program. Ata që për programin për të cilin janë deklaruar, që këtë prej këtyre dy programeve, këtë program kanë dashur ta shtyjnë tutje, nuk e kanë pasur bazamentin për të bërë atë. Këtu ka qenë problemi, nëse janë tre bartës, dy është me rëndësi të jenë të fushës, njëri mund të jetë fleksibil. Varet se nga çka kërkon dhe vendos institucioni. Më pas, ata vendosin se a mund të shkojë përpara dhe natyrisht e kanë aktiv Komisionin e Ankesave dhe janë të hapur, ku i rishikojnë ato programe prapë.

Albena Reshitaj, tha se në korrik të vitit 2023, Ligji për akreditim është vënë në fuqi, sipas nenit, të 50 aktet nënligjore nxirren nga 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ku tash 1 vit pas dhe në bazë të asaj në raport dhe çka ka thënë Këshilli, prapë mbetet sfida, dhe nuk është arritur të nxirret asnjë akt nënligjor as të përfundohet asnjë rregullore, që është shumë shqetësuese. Cilat kanë qenë sfidat gjatë vitit dhe pse nuk janë realizua rregulloret dhe aktet nënligjore nga ligji? Rreth provimit për shkollim specialistik dhe organizimin e shkollimit specialistik, në Ministrinë e Shëndetësisë ekziston UA i nxjerrë nga Ligji për Shëndetësi, që ndihmon dhe organizon provimin specialistik. Por, potencoi se nuk mund të organizohen këto provime pa profesorë të Fakultetit të Mjekësisë. Ajo kërkoi që këto programe duhet të akreditohen, për të pasur vlerën e duhur, sepse shkollimi specialistik është mbi fakultetin, si ekuivalent me doktoratën dhe masterin. Sipas UA 01/2023 për shkollim specialistik, ceket se plan-programi, modulet e programit duhet të jenë specifike, duhet të organizohen nga profesorët dhe akademikët që kanë edhe pjesën e specializimit, kërkohet që nga specialistët të realizohen 80% të ligjëratave për provime specialistike. Kërkohet që specialistët të publikojnë punime shkencore në revista kredibile. E gjithë kjo të bën për të kuptuar që këto programe duhet të akreditohen e të mendohen për akreditim. Viteve të fundit, po bëhen shkelje të ligjit për arsimin e lartë, ligjit për shëndetësi, nga Bordi për shkollim specialistik, që organizon provime specialistike, sepse ata vetë si anëtarë nuk janë legjitim për të bërë një punë të tillë, dhe normalisht, nuk pret nga ata që kanë arrogancën e jo dijen për të reflektuar, për të kërkuar mundësi për të gjetur zgjidhje. Pra, ndodh kur formohen komisione për provim, ku vetëm një anëtar është i fushës së duhur.

Çështja tjetër që ngriti deputetja, ishte për titujt akademikë, që janë marrë në kolegje universitare jo nga universiteti, ku janë bërë disa shkelje, ku kanë vendosur anëtarë të komisionit ose edhe kryesues, duke përdorur tituj të kolegjeve universitare. Andaj, që mos të ndodhin këto, duhet të akreditohen dhe monitorohen, sepse kanë vlerë dhe peshë të lartë.

Hasnije Ilazi, për implementim të ligjit, janë dy lloje të dokumenteve që derivojnë nga ligji, ku i pari lloj janë rregulloret, që obligohet agjencia të prodhojë në implementim të ligjit, dhe e dyta,

ato nga MASHTI. Ato që janë përgjegjësi e tyre, të gjitha janë përfunduar dhe aprovuar, si Rregullorja e Komisionit të Ankesave, Rregullorja për Vlerësimin e Jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë, Rregullorja për Politika për Sigurimin të Brendshëm të Cilësisë së Agjencisë, Rregullorja për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe Kompensimin për Ekspertë të Jashtëm, Manuali për Standarde Akreditimi, dhe Rregullorja për Sistematizimin të Vendeve të Punës së Agjencisë të Akreditimit. Të gjitha të përfunduara dhe aprovuara, që kanë të bëjnë me Agjencinë. Për UA që janë në përgjegjësi të Ministrisë, ata kanë qenë pjesë e grupeve punuese e UA nga Ministria dhe kanë përfunduar punën për UA, që ka të bëjë për financimin e Agjencisë, tani janë në përfundim të Rregullores për minoritete dhe fushat specifike, që do përfundojnë së shpejti, por pse nuk janë bërë deri tash, kjo pyetje, ndoshta më mirë për dikë tjetër.

Naim Gashi, si drejtor i Agjencisë, ka marrë shqetësime, edhe nga palë të tjera të interesit, që Agjencia ka kontakte. Mirëpo, Agjencia nuk e ka në kompetencën e saj akreditimin e specializimeve, edhe pse ka kapacitete, por në bazë të ligjit, ata merren me akreditim vetëm në dy nivele: programet dhe institucioneve. Trendi aktual në vende të BE-së, Agjencinë e Akreditimit, tash e tutje merren vetëm me akreditimin institucional, e jo të programeve. Ata e kanë prezantuar edhe para ENQA-s, që në afatin e gjatë, ata do të mendojnë së bashku edhe me legjislativin, të propozojnë që gradualisht, për shembull, institucionet si Universiteti i Prishtinës, që ka një përvojë shumëvjeçare, pra gradualisht ata të merren vetëm me akreditim institucional, e institucioni vetë të bëjë akreditimin e programeve të veta, që të lejohet liria akademike. Ai plotësisht pajtohet me shqetësimin, por nuk është në kompetencën e tyre dhe nuk kanë një bazë ligjore për të bërë këtë punë.

Albena Reshitaj, tha se është gabim, pasi që ato janë programe arsimore, aty shkohet në ligjëratë, kryhet pjesë praktike e teorike, ato pra nuk mund të organizohen pa akreditim e monitorim. Mund të jetë specialist i jashtëzakonshëm, por nuk është mësimdhënës, pedagog, apo profesor. Përveç pjesës profesionale, duhet të jetë edhe ajo akademike. Duhet të shikohet edhe nga MASHTI, mes akteve nënligjore, që të mendohet të rregullohet kjo, në një të ardhme të afërt, ose edhe të amendamentohet ligji.

Arjeta Fejza, tha se në faqen 23 të raportit, Agjencia ka zbatuar procesin e monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë, sigurisht një pjesë shumë e rëndësishme e gjithë mbarëvajtjes dhe sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, janë edhe procedurat pas akredituese, mirëpo nuk ka shumë informacione për gjetje në këtë proces të monitorimit dhe për procedurat pas akredituese. Përveç që përmenden institucionet që është zhvilluar ky proces dhe shpjegohet se nëse nuk kanë vepruar sipas kushteve të akreditimit, është procedura e vlerësimin të jashtëm. Deputetja kërkoi mi shumë informata për gjetjet. Gjithashtu, përgëzoi për përditësimin e informacione në ueb faqe dhe në rrjete sociale. Në faqen 31, Agjencia për Akreditim tregon se nënshkruan kontratën për digjitalizim të proceseve, që është një proces shumë i rëndësishëm. Pyeti: a ka përfunduar si proces dhe në cilën fazë është?

Hasnije Ilazi, tha se monitorimi ishte pikë e rëndësishme e diskutimit edhe me ekipin vlerësues të ENQA-së. Ashtu siç e përmendi edhe drejtori, edhe ata mendojnë që në një periudhë pesëvjeçare ose pak më shumë duhet të shkojmë në këtë drejtim. Ata duhet të kalojnë nga ajo fazë, ku beson që tanimë e kanë tejkaluar në këtë kontekst, për të qenë agjenci kontrolluese, por më shumë agjenci që promovon kulturën e cilësisë. Monitorimi, në këtë kontekst, nuk është sinonim i kontrollit.

Brenda rregullores për monitorim janë dy pjesë: monitorimi dhe ‘follow up procedure’, ku kërkohet institucioni për të parë se a po respektohen rregullat e akreditimit, me të cilat institucionet janë akredituar. Monitorimi ka ndodh për shkak të kërkesave, kryesisht nga studentë përmes email-it për parregullsi në fakultet dhe programet ku ata studiojnë. Në këtë kontekst, ata kanë kryer monitorimin, raportet e monitorimit janë aprovuar nga bordi, ku ka qenë me bazë për përmirësim. Realisht, njerëzit që vijnë nga BE, nuk mund të besojnë që të bëhen improvizime të tilla në arsim dhe është vështirë për të shpjeguar. Ata kërkojnë nga institucionet që të përmirësohen në këtë proces, por kur vjen koha e ri-akreditimit, do të kërkojnë raportin e përmirësimit të gjendjes në terren.

Naim Gashi, tha se procesi i digjitalizimit ka përfunduar, dhe aktivë, sot i kanë mbi 400 staf akademik për tri ditë që kanë aplikuar përmes platformës së re, që është aktive që nga 1 korrik i këtij viti. Sot është një trajnim me të gjitha institucionet e arsimit të lartë, për shkak se platforma e re ka pasur disa ndryshime minore. Ideja e tyre ka qenë që ta përditësojnë kodimin me teknologjinë më të avancuar, por ‘Front-Desk’ çka e plotësojnë profesorët, të mos ketë ndryshime të mëdha me atë të kaluarën, që të jetë më e lehtë për stafin akademik. Ofrojnë përkrahje teknike 24 orë dhe nuk ka ndodhur që asnjë staf akademik, për shkaqe teknike, të mos mund të aplikojë. Financimi është nga “ADA” austriake, me shumë prej 49 mijë eurosh, ku një pjesë të madhe teknike e profesionale e ka mbuluar Agjencia, me kapacitete të veta, siç është migrimi i të dhënave dhe ruajtja, që janë siguruar nga ata. Për sigurinë kibernetike kujdeset Agjencia Shtetërore e Informacionit, jo ata. Përpara ishte një agjenci private, që ai e ka parë si rrezik të madh. Pra, e konsiderojnë si proces të përfunduar.

Albena Reshitaj, tha se revolucioni i digjitalizimit, ka filluar në fillim të shekullit 21, tash në rend inteligjenca artificiale, shtetet tjera janë duke punuar në programe për ta përdorur në mënyrë të drejtë. Nuk mund ta përdorësh inteligjencën artificiale, pa i pasur proceset e digjitalizuara. Pra, na duhet një punë me hapa më të shpejtë, për ta përqafuar digjitalizimin, që të përdoret inteligjenca artificiale.

Maja Martinoviç, tha se është e kënaqur që të ndajë përvojat e saj dhe të ndihmojë me sugjerimet e saj dhe të gjitha njohuritë e mësuara në procesin e njëjtë në Kroaci, kur ishte e përfshirë në atë proces, kur po implementonin standarde të energjisë, i sheh sfidat e njëjta, që janë pjesë e procesit dhe duhet të bëhen në koordinim me të gjithë aktorët. Ligji është ekzistues, janë duke punuar dhe ligji mund të ndryshojë dhe do të ndryshojë sipas informacioneve kthyesë, që i marrin nga përvojat. Përvoja e saj personale në Kosovë është e shkëlqyeshme dhe është falënderuese për bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe kolegët. Është e lumtur që ENQA po ndan përshtypje të njëjta dhe është një përmirësim i madh që është rritur në vitet e fundit. Kosova në këtë moment është duke udhëhequr me standarde dhe është pjesë e këtij komuniteti të madh në Evropë, por duhet të presim për vendimin përfundimtar. Në këtë proces kanë bërë përmirësime, kanë rishikuar standarde, dhe sipas tyre, do të bëjnë përmirësime edhe të mëntutjeshme dhe do t’i informojnë institucionet për këto. Prandaj, janë duke organizuar konferencën e re në shator, ku jeni të ftuar të gjithë, ku do hapin tema të reja, që mund të përmirësojnë edhe më shumë tërë sistemin. Ky është edhe plani. Në fund, gjëja më e rëndësishme është që të gjithë mund t’i shohin përpjekjet dhe përmirësimet që janë arritur, të gjithë shohin se jemi në rrugë të duhur.

Adrian Gola, në diskutimin e tij, ngriti dy çështje. Fillimisht, ceku se shkenca është shumë dinamike, kornizat ligjore janë gjithmonë të ngushta te shkenca dhe është problem për futjen në kornizë, prandaj ka probleme me formulimin e duhur të dispozitave për Ligjin për Agjencinë e Akreditimit. Theksoi se në këtë kuptim duhet të bëjnë përpjekje maksimale, që të arrihet kompaktësia e kornizës ligjore që rregullon fushën e akreditimit, se po vazhdojmë të kemi interferime e dualizima ligjorë. Zonja Hoxha kishte të drejtë për drejtime profesionale, ku iu referua UA të vitit 2018, që është aktualisht në fuqi, edhe pse me ligj i kanë shfuqizuar dispozitat ligjore dhe nënligjore të akreditimit, që bien ndesh me ligjin. Por, ato mund të interpretohen edhe si të ligjshme aktualisht. Nga ana tjetër, ata kanë kriteret e manualit dhe standardet, duhet të bëhet harmonizimi i komplet kornizës ligjore, që të mos krijohen pretekste ose raste për ankesa apo padi. Me përpjekjet në draftimin e rregulloreve është bërë një punë e mirë, që fillimisht të plotësohet korniza ligjore, duke eliminuar kolizionet, të cilat ende vazhdojnë, por me intensitet më të vogël se në fillim. Plotësimin e kornizës ligjore e siguron parashikueshmërinë juridike dhe institucionale për të gjithë aktorët që përfshihen në këtë proces. Nga MASHTI duhet të konfirmohet për hartimin e UA për përshtatshmërinë e kualifikimeve të bartësve në fushën që ai/ajo aplikon për bartës. E dinë që i referohen Kodit të Erasmus-it, por ai kod nuk i plotëson plotësisht nevojat, e orienton relativisht mirë çështjen e vlerësimit të përshtatshmërisë të kualifikimeve të bartësit, por nuk e ezauron kompleksitetin e rasteve të drejtimeve tradicionale studimore në universitet. UA, që do arrinte të zërthejë përshtatshmërinë e kualifikimeve, përvojës, publikimeve, doktoratës në fushën që aplikon, mendon se do ta rregullonte mirë dhe afatgjatë çështjen e kësaj. U interesua se a po munden për të rritur ose intensivuar bashkëpunimin rajonal, sidomos për programe të doktoratës, ashtu që kriteret që ata i aplikojnë për programe të doktoratës, mos të shndërrohen në një mekanizëm që i penalizon programet e brendshme. NARIC-u, ligjërisht e ka të detyrueshme t'i njohë diplomat nga kudo që vijnë institucionet, ndërkohë që hamendësojmë që ato institucione janë dukshëm më të dobëta në kuptimin e standardeve. Pra, po i rrisim standardet, por po krijojmë një boshllëk duke i reduktuar programet e doktoratës, e nga ana tjetër, po vijnë doktorata edhe më të dobëta. Edhe pse është adresim ndërinstitutional, por edhe rajonal, me rigorozitetin në vlerësim, mund të jenë edhe një shembull i mirë për agjencitë në rajon, që të ngrihet rigoroziteti në zbatimin e ligjit dhe standardeve. Pra, ngritja e kriterëve të jetë e harmonizuar dhe ekuilibruar, që mos t'i penalizojmë programet e brendshme. Çështja e fundit e ngritur nga kryetari, ishte për çështjen e manualit, të jetë e emëruar si rregullore, ku u konfirmua nga kryetarja Ilazi, që është emëruar si rregullore, e cila është në përputhshmëri me kornizën ligjore.

Hasnije Ilazi, tha se rregulloret e kanë minimizuar mundësinë për interpretime të ndryshme për çështjen e njëjtë. UA që u përmend për këtë nuk kanë njohuri, pasi që nuk kanë qenë të ftuar për të qenë pjesë e grupit punues. Në përputhje me manualin, ku i kanë përfillur edhe çështjet nga praktikat paraprake, që ka qenë shumë rigoroze, tash i kanë shtuar shumë kriterë që mund të ndihmojnë dhe mund të jenë bartës mes sub-kodeve. Për bashkëpunimin rajonal, po provojnë tërë kohën, por është problem. E kanë ngritur si çështje me ENQA-n. Përgjigjja nga ENQA, nuk ka qenë shumë optimiste, pasi që nëse një shtet nuk ka pretendime për ENQA dhe EQAR nuk kanë

mekanizma përmes të cilëve mund t'i detyrojnë që t'i përfillin standardet evropiane. Nëse pranohen në ENQA, standardet për pranimin e diplomave do të jenë edhe për agjencinë, sepse duhet të kalojnë kriterin e cilësisë, jo vetëm formalisht. Nga përvoja tjetër, për shembull, shteti i Kroacisë nuk i pranojnë diplomat nga Bosnja e Hercegovina. Është vendim politik, por ndikon në rritjen e cilësisë. Ata kanë bërë disa marrëveshje, por përgjigjja nga vendet e rajonet ka qenë minimale. Diplomat jashtë Kosovës do të trajtohen me standarde të Evropës, nëse bëhen pjesë e ENQA-s dhe EQAR-it.

Çështja e fundit e ngritur nga kryetarja, ishte për anëtarin e bordit nga ana e studentëve, ku sipas ENQA-s, është pika më e dobët, edhe pse nuk është çështja tek ta. Ata i kanë informuar ENQA-n, që kanë mekanizma tjerë, ku studentët janë prezentë në dokumente që prodhohen. ENQA ka pasur kërkesën për përfaqësues për studentë dhe të industrisë. Në MASHTI është hapur thirrja për studentin. Deri në shtator, do ishte përparësi nëse votohet studenti ose për të treguar që po ka lëvizje. Në emër të kolegëve, ftojnë Komisionin për vizitë në zyrat dhe ambientin e ri.

4. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola,

Kryetar i Komisionit